




| | |
|---|-------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT | |
| AGJENCJA PROTIV KORUPCIJE | |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | |
| Dep. | |
| Dep. | <u>AKK-DPKI</u> |
| Nr. i faq. | |
| Broj stranica | <u>02</u> |
| Nr. pages | |
| Nr. Prot. | |
| Br.Prot. | |
| Prot No. | <u>01-2010/16</u> |
| Data | |
| Datum | |
| Date | <u>22.06.2016</u> |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

| | |
|-------------------------------|--|
| DATË/A: | 21.06.2016 |
| REFERENC-Ë: | AKK-DPK 03-02-1668/16 |
| PËR/ZA/TO: | z. Petrit Selimi – Zëvendësministër në Ministrinë e Punëve të Jashtme |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik |

Inderuari z. Selimi,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, me numër protokoli DPKI 03-02-1668/16, në të cilën keni kërkuar sqarim se a paraqet konflikt interesit ushtrimi i funksionit të Koordinatorit Nacional në Koorporaten e Sfidave të Mijëvjeçarit, krahas funksionit publik të zëvendësministrit, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ekziston konflikt interes i në ushtrimin e funksionit të Koordinatorit Nacional në Koorporaten e Sfidave të Mijëvjeçarit krahas funksionit publik të Zëvendësministrat të Punëve të Jashtme.

Arsyetim

Në bazë të Ligjit 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshmë: Ligji PKI), pozita e Zëvendësministrat, hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Sipas këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit (neni 8, par. 1).

Ligji PKI parashev edhe parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit të lartë. Disa prej këtyre parimeve të parashikuara në këtë ligj janë se zyrtari i lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vëré para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar. Pastaj, zyrtari i lartë duhet të kryej punën e tij me ndershëmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institacione. Po ashtu zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shhang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

Ky ligj, në nenin 16 ka përcaktuar kufizimet për zyrtarët e lartë në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik.

Në pikën 1 të këtij nenit parashihet se: “*Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhue të organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektit politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak te funksionit*”.

Bazuar në këtë dispozitë, ju si zyrtar i lartë publik nuk mund të ushtronit njëkohësisht funksionin e Zëvendësministrat dhe atë të Koordinatorit Nacional në Koorporaten e Sfidave të Mijëvjeçarit.

Kjo përfaktin se kjo pozitë hynë në kategorinë e funksioneve menaxhue, të përcaktuara me nenin e lartcituar, që shihet edhe me dokumentin e kësaj Korporate: “Compact Development Team”. Ky dokument, ndër të tjera, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive, pozitën e Koordinatorit Nacional e parashev si funksion menaxhues.

Andaj, bazuar në këto dispozita, këto dy funksione nuk mund të ushtrohen njëkohësisht për shkak se ekziston konflikt interes i në ushtrimin e funksionit publik. Prandaj, që t'i shhangeni kësaj situate, AKK iu rekomandon që të zgjedhni vetëm njërin prej këtyre funksioneve.

Për veprimet e ndërmarra pas këtij rekomandimi të njoftohet Agjencia kundër Korrupsionit.

Me respekt!